FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 133

Tiranë – E mërkurë, 20 korrik 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 71/2016 datë 7.7.2016	Për kontrollin kufitar	10509
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 42, datë 12.7.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 8, datë 5.6.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 8, datë 5.6.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë	10518
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43, datë 12.7.2016	Me objekt: Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 209 të Kodit të Procedurës Civile, në pjesën që nuk njeh të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, që rrëzon kërkesën për caktim mase të sigurimit të padisë, pasi vjen në kundërshtim me nenet 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	10529
	Vendim (*i shkurtuar*)për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ymer Qefa	10535
	Kërkesë për shpalljen e vdekjes dhe të zhdukjes të shtetasit Stiliano Elmazi	10535

LIGJ
Nr. 71/2016

PËR KONTROLLIN KUFITAR[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Kontroll kufitar" është veprimtaria që kryhet në përputhje dhe për qëllim të këtij ligji në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, si përgjigje posaçërisht ndaj një synimi për të kaluar ose aktit të kalimit të kufirit, pavarësisht nga rrethanat dhe që përbëhet nga verifikimi kufitar e mbikëqyrja kufitare.

2. "Mbikëqyrje kufitare" është mbikëqyrja që kryhet në segmentet e kufirit shtetëror midis pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja që kryhet në pikën e kalimit kufitar, jashtë orarit zyrtar, me qëllim që personat të mos shmangin verifikimet kufitare. Segmentet e kufirit shtetëror përfshijnë, gjithashtu, ujërat e brendshme dhe ujërat territoriale.

3. "Pikë e kalimit kufitar" është çdo vend kalimi, i autorizuar nga autoritetet kompetente, për kalimin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

4. "Pikë e përbashkët e kalimit kufitar" është çdo pikë e kalimit kufitar, e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose në territorin e një shteti fqinj, në të cilin rojat kufitare shqiptare dhe rojat kufitare të shtetit fqinj kryejnë verifikime kufitare në hyrje dhe në dalje, njëri pas tjetrit, në përputhje me legjislacionin respektiv kombëtar dhe sipas marrëveshjes përkatëse dypalëshe.

5. "Roja kufitare" është çdo punonjës i Policisë Kufitare dhe të Migracionit, i caktuar në pikën e kalimit kufitar ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror për të kryer detyra të kontrollit kufitar në përputhje me këtë ligj.

6. "Verifikim kufitar" është veprimtaria që kryhet në pikën e kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për të dalë prej tij.

7. "Verifikimi i vijës së dytë" është një verifikim i mëtejshëm, i cili mund të kryhet në një vend të posaçëm, tej vendndodhjes së vijës së parë, në të cilën kryhen verifikime minimale ose tërësore për të gjithë personat.

8. "Zonë e verifikimit kufitar" është një zonë e përcaktuar dhe e shënuar, në të cilën mund të kryhen verifikime sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 3
Menaxhimi i integruar i kufirit

Për zbatimin e këtij ligji, autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me konceptin e "Menaxhimit të integruar të kufirit", i cili udhëhiqet nga parimi i solidaritetit, bazohet në një strategji të shkruar operacionale e teknike dhe përbëhet nga elementet në vijim:

a) kontroll kufitar (verifikim dhe mbikëqyrje), përfshirë masat e ndërmarra së bashku me të gjitha autoritetet e zbatimit të ligjit për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimit ndërkufitar;

b) analizim i risqeve për sigurinë e brendshme dhe analizim i kërcënimeve që mund të ndikojnë funksionimin ose sigurinë e kufijve;

c) bashkëpunim ndërmjet agjencive, Policisë Kufitare dhe të Migracionit, autoritetit doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe të gjitha autoriteteve të tjera, që kanë detyra të lidhura me kufirin, përfshirë shkëmbimin e rregullt të informacionit, përmes mekanizmave ekzistues të shkëmbimit të informacionit;

ç) bashkëpunim me vendet e tjera, duke u fokusuar në veçanti në vendet fqinje dhe në ato

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2016/399 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 9 mars 2016, "Mbi Kodin e Bashkimit Evropian që përcakton rregullat e regjimit të lëvizjes së personave përmes kufijve (Kodi i Kufijve Schengen)", nurmri CELEX 32016R0399, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.77, datë 23.3.2016, faqe 1–52.*

vende të tjera, të cilat janë identifikuar nëpërmjet analizës së riskut si vende origjine dhe transiti për imigracionin ilegal;

d) masa teknike dhe operacionale, të cilat janë të lidhura me kontrollin kufitar dhe synojnë të parandalojnë imigracionin ilegal dhe të godasin krimin ndërkufitar;

dh) kthim i shtetasve të huaj që qëndrojnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) përdorim i teknologjisë së fjalës së fundit, përfshirë sistemet e informacionit me shkallëzim të gjerë;

ë) mekanizëm i kontrollit të cilësisë për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

Neni 4
Të drejtat themelore

1. Autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje të plotë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, konventën e Gjenevës, të datës 28 korrik 1951, "Për statusin e refugjatëve", si dhe me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe detyrimet që lidhen me përfitimin e mbrojtjes ndërkombëtare, së bashku me parimin e moskthimit.

2. Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar, askush nuk mund të diskriminohet për shkak të gjinisë, origjinës racore dhe etnike, fesë, gjuhës, aftësisë së kufizuar, gjendjes ekonomike, moshës ose orientimit seksual.

3. Rojat kufitare, në përmbushje të detyrave të tyre, respektojnë plotësisht dinjitetin njerëzor, veçanërisht në rastet kur përfshihen persona të brishtë. Vëmendje e veçantë u kushtohet të miturve që udhëtojnë të pashoqëruar apo të shoqëruar.

4. Vendimet dhe masat në zbatim të këtij ligji janë proporcionale me objektivat e synuar dhe merren në bazë të shqyrtimit rast pas rasti.

KREU II
KONTROLLI KUFITAR

Neni 5
Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar

1. Kontrolli kufitar është nën juridiksionin administrativ të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

3. Për zbatimin e këtij ligji, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të vendosë dhe të përdorë mjete teknike, përfshirë ato teknologjike, dhe qen shërbimi, si dhe të ngrejë pengesa për të parandaluar personat të shmangin kontrollin kufitar apo të kalojnë kufirin shtetëror jashtë pikave të autorizuara të kalimit kufitar dhe për të zbuluar veprat penale.

4. Në pikat e kalimit kufitar, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të bëjë fotografi, të sigurojë imazhe video-fotografike dhe të përdorë pajisje të tjera automatike, për aq sa ato janë të nevojshme për të verifikuar identitetin e personave dhe për të parandaluar e zbuluar veprat penale, si dhe për të kapur autorët e tyre. Pajisjet instalohen në vende të dukshme dhe publiku informohet për praninë e tyre.

5. Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të zbatojë sisteme të automatizuara të verifikimit kufitar, ku, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike, mblidhen të dhëna për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar të automatizuar.

6. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka në dispozicion burime njerëzore, burime financiare, pajisje dhe teknologji të përshtatshme, të nevojshme për kryerjen e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, në mënyrë të tillë që të sigurojë një nivel të efektshëm, të lartë dhe uniform të kontrollit në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 6
Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në kufi

1. Rojat kufitare, në kuadër të kontrollit kufitar, janë të autorizuara të verifikojnë identitetin e personave, subjekt kontrolli, arsyen për kalimin e kufirit shtetëror, si dhe automjetet e sendet e tyre, nga jashtë dhe nga brenda. Çdo person është i detyruar të bashkëpunojë në verifikimin e identitetit e të arsyeve të kalimit të kufirit shtetëror, të mundësojë zbatimin e menjëhershëm të kësaj mase, si dhe të sigurojë që automjeti e sendet e tij të mund të verifikohen.

2. Rojat kufitare, në kuadër të verifikimit kufitar, duhet t'u japin nëpunësve të doganave apo nëpunësve të çdo autoriteti tjetër përgjegjës që operon në kufirin shtetëror mundësinë e kryerjes së verifikimeve të përbashkëta me ta, kur këta janë të pranishëm gjatë verifikimit kufitar. Rregullat për kryerjen e verifikimeve kufitare të përbashkëta përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Rojat kufitare kanë të drejtë, në kuadër të kontrollit kufitar:

a) të verifikojnë:

i) origjinalitetin e dokumenteve të udhëtimit, duke përdorur certifikatat e siguruara në përputhje me legjislacionin për gjendjen civile, dokumentet e identifikimit dhe dokumentet e udhëtimit;

ii) në rast dyshimi të arsyeshëm, identitetin e mbajtësit të dokumenteve të udhëtimit ose vizës, duke krahasuar identifikuesit biometrikë të depozituar në çdo bazë të dhënash, përveç ADN-së, me personin që po verifikohet;

b) të sekuestrojnë dokumente udhëtimi, të cilat kanë tregues që justifikojnë dyshimin se:

i) dokumenti i udhëtimit ose viza te dokumenti i udhëtimit është e falsifikuar ose e rremë;

ii) janë përdorur për të siguruar informacion të rremë për një person.

Nëse vërtetohet se një dokument i sekuestruar nuk është objekt i ndonjë mase të parashikuar nga Kodi Penal, u dorëzohet autoriteteve kompetente, për aq kohë sa është i nevojshëm sekuestrimi dhe, më pas, i kthehet personit ose shtetit që ka lëshuar dokumentin.

4. Rojat kufitare, për arsye të kontrollit të qarkullimit kufitar dhe për të kryer kontrollin kufitar, kanë të drejtë të hyjnë në çdo ngastër toke dhe në të gjithë ujërat, si dhe të drejtojnë automjetet në çdo rrugë, për sa kohë kjo është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tyre.

5. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë të drejtën të refuzojnë hyrjen dhe daljen e një të huaji, në përputhje me parashikimet e ligjit për të huajt.

6. Rojat kufitare, për arsye të verifikimit kufitar, kanë, gjithashtu, të drejtën t'u refuzojnë daljen personave:

a) që nuk kanë një dokument të vlefshëm udhëtimi;

b) për të cilët ka një urdhër gjykate që ndalon daljen nga Republika e Shqipërisë;

c) që duan t'i fshihen ndjekjes penale, ndalimit, arrestimit apo ekzekutimit të dënimit me burgim;

ç) të cilëve u është bllokuar pasaporta, karta e identitetit, pasaporta për të huaj apo pasaporta për refugjatë, ose për të cilët ka një urdhër apo një vendim për bllokim apo kufizim të vlefshmërisë territoriale të dokumentacionit të sipërpërmendur, ose për cilët ka prova thelbësore që çojnë në përfundimin se ka arsye për të bllokuar dokumentin e personit apo për të kufizuar vlefshmërinë e tij territoriale;

d) që u është mohuar lëshimi i dokumenteve të udhëtimit, të përmendura në shkronjën "ç" të kësaj pike;

dh) të cilët, gjatë daljes nga Republika e Shqipërisë, përdorin dokumentin e një personi tjetër ose dokument të falsifikuar;

e) të cilët janë të regjistruar në dokumentin e udhëtimit të dikujt tjetër dhe, gjatë daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, nuk janë të shoqëruar nga personi në dokumentin e të cilit janë regjistruar.

7. Rojat kufitare kanë të drejtë të zbatojnë me forcë masat e përmendura në pikat 1, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni.

Neni 7

Kompetencat e Policisë Kufitare dhe të Migracionit në brendësi të territorit

1. Policia e Kufirit dhe e Migracionit ka të drejtë që, në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë, të marrë masa për të zbuluar të huajt që qëndrojnë ose që kalojnë transit në territorin e Republikës së Shqipërisë në mënyrë të paligjshme, si dhe të parandalojë, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkufitar.

2. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të verifikojë dhe të intervistojë persona, të verifikojë sende dhe mjete transporti, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim ndalimin e hyrjes, kalimit transit dhe qëndrimit të paligjshëm të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

3. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka, gjithashtu, të drejtë të ndërmarrë veprime hetimore dhe procedurale në rastet e veprave penale që lidhen me kufirin, përveç atyre veprave që janë përcaktuar të ndiqen posaçërisht nga struktura të tjera të Policisë ose agjenci të tjera.

Neni 8
Pikat e kalimit kufitar

1. Një pikë kalimi kufitar hapet dhe përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet e pikave të kalimit kufitar tokësor, vendimi bazohet në një marrëveshje ndërkombëtare. Në marrëveshje ose në vendimin e Këshillit të Ministrave përcaktohen, gjithashtu, vendndodhja dhe kufizime të mundshme për grupe personash, llojin e qarkullimit ose kufizimet gjeografike.

2. Si përjashtim nga pika 1 e këtij neni, titullari vendor i Policisë Kufitare dhe të Migracionit, pas konsultimit me autoritetin qendror të Policisë Kufitare dhe të Migracionit, ka të drejtë të nxjerrë urdhër të argumentuar për hapjen e një pike të përkohshme të kalimit kufitar në zonën përkatëse të juridiksionit të tij. Pika e përkohshme e kalimit kufitar do të funksionojë deri në maksimalisht 14 ditë rresht, kur ajo është e nevojshme për sigurimin e zbatimit të projekteve të qarkullimit lokal ndërkufitar, si: aktivitet kulturor, turistik, shkencor, sportiv, ushtrim i emergjencave civile, masa për devijim të qarkullimit rrugor ose veprimtari bujqësore apo pyjore. Në urdhrin për hapjen e pikës së përkohshme të kalimit kufitar përfshihen vendndodhja, orari zyrtar, si dhe kufizimet e mundshme për grupe personash, lloji i qarkullimit ose kufizimet gjeografike dhe ky urdhër bazohet në konsultimet me autoritetet lokale që lidhen me kontrollin kufitar.

3. Shpenzimet, që lindin për hapjen e pikave të përkohshme të kalimit kufitar, të cilat nuk i shërbejnë qarkullimit kufitar të publikut të gjerë, por vetëm disa personave, përballohen nga pala që bën kërkesën për hapjen e pikës së përkohshme të kalimit kufitar.

4. Gjatë lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare ose nxjerrjes së vendimit të Këshillit të Ministrave, të përmendur në pikën 1 të këtij neni, dhe gjatë hartimit të urdhrit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, merren parasysh aspektet e rendit dhe të sigurisë publike, marrëdhëniet ekonomike dhe lidhjet ekzistuese ndërkufitare, qarkullimi i pritshëm dhe kapaciteti i burimeve të përshtatshme njerëzore për të plotësuar me personel pikën e kalimit kufitar, parashikimet doganore apo të aviacionit dhe marrëveshjet ekzistuese dypalëshe.

Neni 9
Infrastruktura në pikat e kalimit kufitar

1. Pikat e kalimit kufitar përshtaten në mënyrë të tillë që verifikimet kufitare të mund të kryhen në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Operatorët e aeroporteve dhe porteve, si dhe autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve duhet të garantojnë, nëpërmjet infrastrukturës së përshtatshme dhe masave organizative, që kontrollet kufitare në aeroporte dhe porte të kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Shpenzimet që rrjedhin nga këto aktivitete përballohen nga operatorët respektivë të aeroporteve dhe porteve, si dhe nga autoritetet përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve.

Neni 10
Zona e verifikimit kufitar

1. Çdo pikë e kalimit kufitar në kufijtë tokësorë ka një zonë të verifikimit kufitar, që është 2 km në brendësi të territorit, në formë rrethore, përreth pikës së kalimit kufitar. Brenda kësaj zone, rojat kufitare janë të autorizuara të kryejnë verifikime kufitare, sipas kompetencave të dhëna atyre në këtë ligj.

2. Zona e verifikimit kufitar në qarkullimin hekurudhor mbulon shinat dhe ambiente të tjera të hekurudhës, nga pika e kalimit kufitar deri në brendësi të vendit, në aq shtrirje sa është e nevojshme për të kryer verifikime kufitare të efektshme.

3. Zona e verifikimit kufitar në aeroporte dhe porte, që janë pika të kalimit kufitar, mbulon gjithë territorin e aeroportit e të portit.

4. Për pikat e kalimit kufitar, të vendosura në shtetin fqinj, zona e verifikimit kufitar në shtetin fqinj përcaktohet në marrëveshjen ndërkombëtare dypalëshe që rregullon pikën e përbashkët të kalimit kufitar. Në marrëveshje autorizohen, gjithashtu, rojat kufitare që të kryejnë detyrat e tyre në një zonë të përcaktuar në vendin fqinj. Çdo verifikim, që kryhet brenda kësaj zone të përcaktuar të pikës së përbashkët të kalimit kufitar, konsiderohet të jetë kryer në zonën e kompetencës së autoritetit vendor të Policisë Kufitare dhe të Migracionit që ka, gjithashtu, kompetencën territoriale për pikën e kalimit kufitar.

Neni 11
Tabelat dhe simbolet në pikat e kalimit kufitar dhe në zonën e verifikimit kufitar

1. Pikat e kalimit kufitar, në afërsi të tyre, shënohen me tabela. Tabelat përmbajnë simbolet kombëtare dhe mbishkrimin "Pikë e kalimit kufitar". Orari zyrtar i pikës dhe kufizimet e mundshme mbi llojin e qarkullimit paraqiten me tabela shtesë.

2. Nuk vendosen ose nuk ngjiten tabela, për:

a) pikat e kalimit kufitar për trafikun hekurudhor;

b) pikat e përkohshme të kalimit kufitar;

c) pikat e kalimit kufitar që shtrihen në më shumë se 100 metra përgjatë kufirit shtetëror.

3. Në të gjitha rrugët kryesore që çojnë në kufi, si dhe në porte e aeroporte, zona e verifikimit kufitar shënohet me tabela.

4. Për të lehtësuar mbarëvajtjen e verifikimit kufitar, në pikat ajrore të kalimit kufitar sigurohen korsi të ndara, të shënuara me tabela. Korsi të ndara me tabela të veçanta mund të sigurohen, gjithashtu, edhe në pikat tokësore dhe detare të kalimit kufitar.

5. Në rast të një çekuilibrimi të përkohshëm të fluksit të qarkullimit, rregullat në lidhje me përdorimin e korsive të ndryshme mund të shmangen, për sa kohë është e nevojshme për të eliminuar këtë çekuilibrim. Vendimi për këtë merret nga roja kufitare më e lartë që është në shërbim në pikën e kalimit kufitar.

6. Tabelat dhe simbolet e përmendura në pikat 1, 3 dhe 4, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Pronarët e hapësirave, që i shërbejnë qarkullimit kufitar, duhet të lejojnë vendosjen e tabelave dhe tabelave shtesë.

Neni 12
Kalimi i kufirit

1. Kalimi i kufirit shtetëror lejohet vetëm në pikat e autorizuara të kalimit kufitar, brenda orarit zyrtar të punës. Në pikat e kalimit kufitar, që nuk janë të hapura 24 orë, orari zyrtar shpallet në mënyrë të dukshme.

2. Përjashtimisht nga rregulli i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, në rastet e forcës madhore ose nëse parashikohet shprehimisht në një marrëveshje ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, kufiri shtetëror mund të kalohet në çdo vend dhe në çdo kohë. Autoriteti i parë vendor ose shtetëror që njihet me ngjarjen, informon pa asnjë vonesë Policinë Kufitare dhe të Migracionit.

Neni 13
Verifikimet kufitare

1. Të gjitha lëvizjet ndërkufitare në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë janë subjekt i verifikimeve kufitare nga rojat kufitare.

2. Kalimi i kufirit shtetëror në një pikë të kalimit kufitar, ashtu dhe hyrja në rrethana të jashtëzakonshme dhe emergjence në territorin e Republikës së Shqipërisë, me anije ose me avion, jashtë territorit të aeroportit apo portit të përcaktuar si pikë e kalimit kufitar detyron personin t'i nënshtrohet verifikimit kufitar.

3. Kushdo që ka synim të kalojë kufirin shtetëror ose që sapo e ka kaluar atë, në një pikë të autorizuar të kalimit kufitar, i nënshtrohet verifikimit kufitar dhe është i detyruar që, brenda zonës së verifikimit kufitar:

a) të japë informacion nëse ka kaluar ose ka për synim ta kalojë kufirin;

b) të kalojë, pa asnjë vonesë, në korsitë e përcaktuara për verifikimin kufitar në zonën e verifikimit kufitar, si dhe të zbatojë urdhrat për kryerjen në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë të shpejtë të verifikimit kufitar.

4. Në verifikimet kufitare mund të përfshihen mjetet e transportit dhe sendet në zotërim të personave që kalojnë kufirin shtetëror.

Neni 14
Verifikimi kufitar i personave

1. Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili përbëhet nga:

a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e, veçanërisht, me:

i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit;

ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit;

iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave, të njohura nga Republika e Shqipërisë;

b) verifikimi që personi, mjeti i tij i transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse.

Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit.

2. Të huajt, krahas verifikimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, janë subjekt i verifikimeve tërësore në hyrje dhe në dalje, të cilat konsistojnë në verifikimin e plotësimit të të gjitha kushteve për kalimin e kufirit shtetëror.

3. Verifikimet kufitare tërësore në hyrje përbëhen nga:

a) verifikimi i të huajit nëse ai posedon, për kalimin e kufirit shtetëror, një dokument udhëtimi të njohur nga Republika e Shqipërisë, të shoqëruar me vizë ose leje qëndrimi, kur kjo kërkohet nga legjislacioni;

b) këqyrja e plotë e dokumentit për ndonjë shenjë falsifikimi, sajimi apo tjetërsimi;

c) shqyrtimi i vulave të hyrjeve/daljeve në dokumentin e udhëtimit, duke i krahasuar me të dhënat në bazat e të dhënave të hyrjeve/daljeve, për të verifikuar nëse i huaji ka tejkaluar afatin e autorizuar të qëndrimit në territorin e vendit;

ç) verifikimi i dokumentacionit për nisjen, destinacionin dhe arsyen e qëndrimit të personit;

d) verifikimi i të huajit nëse ai ka mjete të mjaftueshme financiare për kohën dhe qëllimin e qëndrimit, si dhe për kthimin në vendin e origjinës apo për kalimin transit në një vend të tretë ku i lejohet të hyjë ose verifikimi se ai është në gjendje t'i sigurojë këto mjete financiare në mënyrë të ligjshme.

4. Verifikimet kufitare tërësore në dalje përbëhen nga:

a) verifikimi nëse personi posedon një vizë të vlefshme, në qoftë se kjo kërkohet, përveçse kur ai mban një leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar në Republikën e Shqipërisë ose dokumente të tjera që autorizojnë qëndrim apo rihyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) verifikimi nëse personi ka shkelur afatin e lejuar të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, në qoftë se ai është subjekt i një afati të limituar qëndrimi.

5. Përjashtimisht, shtetasit e Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane, Zvicrës, Andorrës, Monakos dhe San-Marinos, si dhe të huajt që janë familjarë të tyre dhe që gëzojnë të drejtën e Bashkimit Evropian për lëvizje të lirë ose që janë familjarë të shtetasve shqiptarë, në rast se identiteti dhe lidhjet familjare të tyre provohen, i nënshtrohen verifikimit minimal. Përkufizimi i anëtarëve të familjes në ligjin për të huajt është i vlefshëm, gjithashtu, dhe për këtë ligj.

6. Personat, që janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, në bazë të analizës së riskut dhe në mënyrë josistematike, mund t'i nënshtrohen verifikimit tërësor.

7. Nëse, nga rezultatet e verifikimit në vijën e parë, konsiderohen të nevojshme verifikime të mëtejshme, personit i kërkohet t'i nënshtrohet verifikimit në vijën e dytë, i cili mund të përfshijë verifikime të hollësishme personale, verifikime të hollësishme të sendeve në posedim dhe inspektime të hollësishme të automjetit.

8. Aty ku janë kushtet, verifikimet e vijës së dytë kryhen në ambiente të përshtatura posaçërisht për këtë qëllim.

9. Të gjithë personat, që janë subjekt i verifikimit në vijën e dytë, informohen me shkrim për qëllimin dhe procedurat që ndiqen gjatë këtij verifikimi, në një gjuhë që e kuptojnë apo që ka arsye për të besuar se e kuptojnë ose në një mënyrë tjetër efektive. Informacioni pasqyron të drejtën që ka personi, subjekt i verifikimit në vijën e dytë, për të kërkuar emrin ose numrin e identifikimit të rojës kufitare që kryen verifikimin tërësor në vijën e dytë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën kur është kaluar kufiri shtetëror. Përmbajtja e këtij informacioni përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

10. Si përjashtim nga rregullat e përgjithshme të verifikimit kufitar, për kategori të caktuara personash dhe mjetesh transporti zbatohen rregulla të veçanta, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 15
Verifikimi i sendeve dhe mjeteve të transportit

1. Verifikimi i sendeve përfshin sendet personale që zotëron personi që kalon kufirin shtetëror.

2. Në rast se ka dyshime për sende ose objekte të ndaluara të fshehura ose për të verifikuar identitetin e një personi, roja kufitare i kërkon personit të paraqesë të gjitha sendet që ka në zotërim për të bërë të mundur që objektet të këqyren nga brenda dhe jashtë.

3. Verifikimi i mjeteve të transportit përfshin inspektimin me sy, nga brenda dhe nga jashtë, të mjeteve të transportit dhe verifikimin në bazat përkatëse të të dhënave.

4. Objektet ose sendet e tjera që zbulohen gjatë verifikimit dhe procedurës së inspektimit, të cilat nuk janë objekt i punës së Policisë Kufitare dhe të Migracionit, u dorëzohen autoriteteve doganore ose autoriteteve të tjera përgjegjëse që operojnë në kufi. Procedurat e verifikimit dhe inspektimit zbatohen dhe vendimet në rrjedhim të tyre merren në bashkëpunim me autoritetet e përfshira.

Neni 16
Vulosja e dokumenteve të udhëtimit

1. Dokumentet e udhëtimit të të huajve vulosen rregullisht në hyrje dhe në dalje të kufirit shtetëror. Kurdo që është e mundur, i huaji informohet për këtë detyrim. Specifikisht, vulat për hyrjen dhe daljen vendosen në:

a) dokumentet me vizë të vlefshme që lejojnë personat të kalojnë kufirin shtetëror;

b) dokumentet që lejojnë personat të kalojnë kufirin shtetëror, pasi u është lëshuar një vizë në kufi;

c) dokumentet që lejojnë të kalojnë kufirin shtetëror personat që nuk kanë nevojë për vizë.

2. Nuk vendoset vulë në hyrje ose dalje në:

a) dokumentet e udhëtimit të shtetasve të Republikës së Shqipërisë, të Bashkimit Evropian, të Zonës Ekonomike Evropiane, të Zvicrës, të Andorrës, të Monakos dhe të San-Marinos;

b) dokumentet e udhëtimit të kryetarëve të shteteve e të personaliteteve, mbërritja e të cilëve është njoftuar paraprakisht, nëpërmjet kanaleve diplomatike;

c) licencat e pilotëve ose certifikatat e anëtarëve të ekuipazhit të avionit;

ç)dokumentet e udhëtimit të marinarëve, brenda zonës së verifikimit kufitar të portit në të cilin anija e tyre ankorohet;

d) dokumentet e udhëtimit të ekuipazhit dhe pasagjerëve të anijeve turistike që nuk janë subjekt i verifikimit kufitar;

dh) dokumentet e banorëve kufitarë që përfitojnë regjim të qarkullimit lokal kufitar;

e) dokumentet e udhëtimit të të huajve që paraqesin një leje të vlefshme qëndrimi, në përputhje me legjislacionin për të huajt;

ë) dokumentet e udhëtimit të ekuipazhit të trenave të udhëtarëve dhe të mallrave në linjat ndërkombëtare.

3. Dokumentet e udhëtimit të të huajve, që janë anëtarë të familjeve të shtetasve të Republikës së Shqipërisë, të shtetasve të Bashkimit Evropian, të shtetasve të Zonës Ekonomike Evropiane dhe të shtetasve të Zvicrës, Andorrës, Monakos dhe San--Marinos, por të cilët nuk paraqesin një leje qëndrimi të vlefshme, duhet të vulosen në hyrje dhe në dalje.

4. Si përjashtim, me kërkesë të të huajit, mund të mos bëhet vendosja e vulës së hyrje-daljes, nëse vendosja e saj mund të krijojë vështirësi serioze për personin. Në këtë rast, vula e hyrjes dhe e daljes vendoset në një fletë më vete, ku specifikohen emri dhe mbiemri i personit, si dhe numri i pasaportës. Kjo fletë i dorëzohet shtetasit të huaj. Policia Kufitare dhe e Migracionit mban statistika për këto raste përjashtimore.

5. Formati dhe specifikimet teknike të vulave, si dhe rregullat praktike për vulosjen përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17
Lehtësimi i verifikimeve kufitare

1. Verifikimet kufitare mund të lehtësohen në situata të veçanta dhe të paparashikuara, që sjellin ngarkesë në qarkullim në pikën e kalimit kufitar dhe kur të gjitha burimet që lidhen me personelin, pajisjet, ambientet dhe organizimin janë shteruar.

2. Vendimi për lehtësim, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, merret nga roja kufitare më e lartë që është në shërbim në pikën e kalimit kufitar.

3. Lehtësimi i verifikimeve është i përkohshëm, në përputhje me rrethanat justifikuese të tij dhe zbatohet gradualisht.

4. Kur verifikimet kufitare janë të lehtësuara, verifikimet kufitare të lëvizjeve në hyrje, si parim, fitojnë përparësi ndaj verifikimeve kufitare të lëvizjeve në dalje.

5. Në rastet kur verifikimet kufitare janë të lehtësuara, rojat kufitare mund të mos kryejnë regjistrimin, por, pas verifikimit të vlefshmërisë së dokumentit dhe të identitetit të mbajtësit, duhet të vulosin dokumentet e udhëtimit të të huajve në hyrje dhe në dalje, siç parashikohet në nenin 16 të këtij ligji.

6. Në pikën e kalimit kufitar mbahen regjistrimet për arsyet, kohën e fillimit dhe kohën e përfundimit të lehtësimit.

Neni 18
Mbikëqyrja e kufirit

1. Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes kufitare është të parandalojë kalimet e paautorizuara të kufirit, të zbulojë dhe të luftojë krimin ndërkufitar, si dhe të marrë masa ndaj personave që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.

2. Mbikëqyrja midis pikave të kalimit kufitar kryhet nga rojat kufitare, numri dhe metodat e të cilave janë të përshtatura sipas rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese apo atyre të parashikuara. Mbikëqyrja përfshin ndryshime të shpeshta dhe të papritura të periudhave të saj, në mënyrë të tillë që kalimet e paautorizuara të kufirit dhe krimi ndërkufitar të jenë përherë në risk të lartë për t'u zbuluar.

3. Mbikëqyrja kryhet me njësi stacionare ose të lëvizshme, të cilat kryejnë detyrën duke patrulluar ose duke u pozicionuar në vende të njohura apo të vlerësuara si me risk të lartë, duke pasur qëllim zbulimin dhe kapjen e personave, që kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme.

Neni 19
Marrëveshjet

1. Këshilli i Ministrave, në përputhje me interesin publik, mund të lidhë marrëveshje ndërkombëtare, nëpërmjet të cilave:

a) hapen pika të kalimit kufitar, sipas kuptimit të pikës 1, të nenit 8, të këtij ligji;

b) kalimi i kufirit në një seksion të caktuar të tij rregullohet ndryshe nga sa parashikohet në pikën 1, të nenit 12, të këtij ligji;

c) normohet bashkëpunimi ndërkufitar, me qëllim rritjen në mënyrë të ndërsjellë të sigurisë kufitare.

2. Nëse një marrëveshje për kalimin e kufirit, për kontrollin kufitar ose për bashkëpunimin ndërkufitar, parashikon në mënyrë të përgjithshme përgjegjësinë e një autoriteti shqiptar të zbatimit të ligjit, pa iu referuar posaçërisht një instance të caktuar si autoritet përgjegjës, atëherë kompetenca i takon ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike mund t'ia delegojë kompetencën e përmendur në pikën 2 të këtij neni, plotësisht ose pjesërisht, një strukture të varësisë, nëse nuk është e ndaluar në bazë të marrëdhënieve të bazuara në të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë dhe nëse kjo është në interes të zbatimit të marrëveshjes në mënyrë më të përshtatshme, më të thjeshtë dhe me kosto më efektive.

KREU III
ADMINISTRIMI I TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 20
Mbledhja, përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale

1. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka të drejtë të mbledhë në mënyrë të drejtpërdrejtë të dhëna personale të personave që janë subjekt i kontrollit kufitar dhe:

a) të regjistrojë manualisht të dhëna;

b) të shënojë manualisht ose elektronikisht të dhënat në një sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave;

c) të identifikojë dhe të regjistrojë të dhëna, për qëllim dhe në kohëzgjatje të verifikimeve kufitare të automatizuara, në rast të përdorimit të pajisjeve për verifikim kufitar të automatizuar;

ç) t'i përdorë ato për kërkime, në kuptimin e menaxhimit të sigurisë dhe të aktivitetit me autoritetet e sigurisë që i shërbejnë drejtësisë penale;

d) në raste dyshimi për një vepër penale, t'i vendosë në dispozicion të një autoriteti tjetër të sigurisë, për qëllime të zbatimit të ligjit, brenda kompetencës ligjore të atij autoriteti.

2. Vendimet për hyrjet dhe daljet depozitohen në sistem kompjuterik të përpunimit të të dhënave.

3. Rregullat për administrimin e të dhënave të grumbulluara nga zbatimi i këtij ligji përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës

për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KREU IV
SANKSIONET

Neni 21
Sanksionet

1. Konsiderohen kundërvajtje administrative, nëse nuk përbëjnë vepër penale, veprimet ose mosveprimet e çdo personi që:

a) nuk përmbush detyrimet në lidhje me kontrollin kufitar, në përputhje me pikën 1, të nenit 6, të këtij ligji;

b) pengon rojat kufitare të hyjnë, për detyra të kontrollit kufitar, në zonat e parashikuara në pikën 4, të nenit 6, të këtij ligji;

c) nuk plotëson detyrimet në përputhje me pikën 2, të nenit 9, të këtij ligji, në lidhje me kushtet që ndihmojnë për kontroll kufitar të përshtatshëm;

ç) pengon vendosjen, fshin, mbulon ose tjetërson një nga tabelat e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji;

d) kalon kufirin në kundërshtim me parashikimet e nenit 12 të këtij ligji;

dh) nuk plotëson detyrimet në lidhje me informimin e rojës kufitare, në përputhje me pikën 2, të nenit12, të këtij ligji;

e) nuk paraqitet për verifikim kufitar në pikën e kalimit kufitar, në përputhje me pikën 2, të nenit 13, të këtij ligji;

ë) pavarësisht paralajmërimit, refuzon të japë informacion nëse e ka kaluar kufirin shtetëror apo nëse ka qëllim ta bëjë këtë ose jep informacion të pavërtetë, përkundër parashikimeve në shkronjën "a", të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji;

f) synon të kalojë kufirin shtetëror ose ka kryer kalimin e kufirit dhe, megjithëse ka marrë instruksionet, nuk ndjek korsitë e parashikuara për kalimin e kufirit, në përputhje me pikën 3, të nenit 13, të këtij ligji;

g) pavarësisht paralajmërimeve, nuk respekton një vendim të marrë në përputhje me shkronjën "b", të pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji, duke shkaktuar kështu pengesa dhe vonesa në verifikimin kufitar ose vonesë për mjetet e transportit që kalojnë kufirin sipas një orari të caktuar.

2. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat "a", "ç" dhe "f", të pikës 1 të këtij neni, kur kryhen nga persona fizikë, dënohen me gjobë nga 5 000 deri 50 000 lekë.

3. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat "b", "c", "d", "dh", "e", "ë" dhe "g", të pikës 1 të këtij neni, kur kryhen nga persona fizikë, dënohen me gjobë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.

4. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c", "dh", "e", "ë", "f" dhe "g", të pikës 1 të këtij neni, gjobiten përkatësisht trefishin e shumës së parashikuar për personat fizikë, në rast të kryerjes së tyre nga personat juridikë ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë.

5. Kundërvajtjet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "ë", "f" dhe "g", të pikës 1 të këtij neni, gjobiten përkatësisht pesëfishin e shumës së parashikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, për personat fizikë ose pesëfishin e parashikimit të pikës 4 të këtij neni, në rast se personi i kryen ato duke përdorur mjete lundrimi ose fluturimi.

Neni 22
E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i gjobave

1. Gjobat e parashikuara në këtë ligj vendosen nga rojat kufitare dhe janë titull ekzekutiv.

2. E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i sanksioneve, të parashikuara në këtë ligj, zbatohet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Dispozita kalimtare

1. Kufizimet e trafikut ndërkufitar, që rrjedhin nga dispozita të tjera për rrugë të caktuara, për transportin hekurudhor, ajror dhe me mjete lundruese, nuk ndikohen nga dispozitat e neneve 8 dhe 11 të këtij ligji.

2. Pikat e kalimit kufitar dhe zonat transit, të cilat janë hapur para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë pika kalimi kufitar dhe zona transit, sipas këtij ligji. Lista e të gjitha pikave të kalimit kufitar dhe zonave transit të hapura, ekzistuese përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet brenda 2 muajve në rast ndryshimi.

3. Pikat e kalimit kufitar, të përmendura në pikën 2 të këtij neni, brenda dy vjetëve nga hyrja në

fuqi e këtij ligji, pajisen me tabela të posaçme, siç përcaktohet në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 24
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 6; të pikës 6, të nenit 11; të pikës 10, të nenit 14; dhe të pikës 5, të nenit 16, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 9, të nenit 14, dhe të pikës 2, të nenit 23, të këtij ligji.

Neni 25
Shfuqizime

Nenet 1 dhe 2, pikat 3 deri në 16, të nenit 4, nenet 5, 6, 7 e 8, nenet 13 deri në 50, shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të nenit 51, shkronjat nga "d" deri në "g", të pikës 1, dhe pika 2, e nenit 51, të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008, "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror", të ndryshuar, shfuqizohen.

Neni 26
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 7.7.2016

Shpallur me dekretin nr. 9704, datë 16.7.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 42, datë 12.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 12.4.2016, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 7 Akti, që i përket:

KËRKUES: Edi Paloka

SUBJEKT I INTERESUAR: Edi Rama

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 8, datë 5.6.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 8, datë 5.6.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/1/g dhe 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Siç rezulton nga materialet e dosjes gjyqësore, në datën 7 janar 2015, shtetasi Edi Paloka, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në ambientet e selisë së Partisë Demokratike dhe në

prani të përfaqësuesve të mediave, ka lexuar deklaratën me përmbajtjen e mëposhtme:

"*Fakte tronditëse, të bëra publike, tregojnë qartë se banda e armatosur që terrorizoi Tiranën në përplasje të përgjakshme dy net më parë është e lidhur me qeverinë dhe ushtron aktivitetin kriminal me dijeninë dhe mbrojtjen e plotë të saj.*

Oficeri i policisë është në shërbim të bandës. Anëtari i bandës hyn dhe del nga zyra qendrore e Partisë Socialiste. Të gjitha strukturat e qeverisë ishin dje në dispozicion të kreut të bandës, që nga shërbimet spitalore e deri te shoqërimi i tij me polici në banesë.

Ka të dhëna shumë shqetësuese se policia ka kryer kontrolle në banesat e biznesmenëve, të cilët janë gjobitur nga banda kriminale. Pra, ministri i Brendshëm e di që miku i tij vë gjoba dhe ai nuk bën asgjë për të mbrojtur viktimat, por u sulet viktimave për interesat e bandës. Pati dje dezinformim të vazhdueshëm dhe mungesë transparence, në favor të bandës.

Këto ngjarje të rënda kanë ndodhur në 24 orët e fundit, që kanë tronditur mbarë opinionin publik dhe gjithë qytetarët e vendit.

Vetëm Edi Rama heshtë. Asnjë fjalë, asnjë reagim. Ky aktivitet kriminal ndodh sigurisht në dijeninë e tij të plotë. Rama ka përfituar nga shërbimet e bandës gjatë fushatës zgjedhore, në blerjen e në marrjen me forcë të votave. Tani ai po i kthen bandës favoret, duke i ofruar shërbimet e tij. E lejon të vërë gjoba e të terrorizojë biznesmenë e qytetarë. U jep oficerë policie në dispozicion për t'i dhënë siguri dhe mbrojtje. Kujdeset për bandën në çdo drejtim që armët të mos gjenden, provat të mos gjenden, që kreu i saj të mos qëndrojë më shumë se disa minuta në zyrat e Drejtorisë së Policisë.

Këto janë të vërtetat e kësaj qeverie, kështu sundon oligarkia në pushtet.

Me bandat, nga bandat dhe për bandat.

Ju faleminderit!".

2. Kjo deklaratë është transmetuar e plotë në datën 7 janar 2015 nga mediat vizive, si dhe është botuar dhe komentuar të nesërmen, në datën 8 janar 2015, në gazetat "Panorama", "Mapo", "Shqip" dhe "Gazeta Shqiptare". Deklarimi i mësipërm përbën shkakun që i dëmtuari akuzues, subjekti i interesuar, E.R., i është drejtuar me kërkesë për gjykim Gjykatës së Lartë, kundër kërkuesit, me pretendimin se nga i akuzuar janë konsumuar elementet e veprave penale "Fyerje e kryer botërisht", e parashikuar nga neni 119/2 i Kodit Penal (KP) dhe "Shpifje e kryer botërisht" e parashikuar nga neni 120/2 i KP-së, si dhe dënimin e të akuzuarit sipas këtyre dispozitave.

3. Pas përfundimit të gjykimit, me vendimin nr. 8, datë 5.6.2015, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Deklarimin të pafajshëm të të akuzuarit Edi Paloka për veprën penale të fyerjes së kryer botërisht, të parashikuar nga neni 119/2 i KP-së, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale. Deklarimin fajtor të të akuzuarit Edi Paloka për veprën penale të shpifjes së kryer botërisht në dëm të të dëmtuarit akuzues Edi Rama dhe në bazë të nenit 120/2 të KP-së dënimin e tij me 200.000 (dyqind mijë) lekë gjobë.*".

II

4. ***Kërkuesi*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të kërkesës, duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur këto shkaqe:

4.1 Vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është shpallur dhe arsyetuar brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 19 i ligjit organik të Gjykatës së Lartë.

4.2 Vendimi vjen në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë për veprat penale të parashikuara nga nenet 119 dhe 120 të KP-së, sipas së cilës liria e fjalës dhe e shprehjes prevalon dhe se politikani duhet të denoncojë çdo fenomen të kundërligjshëm që vjen si pasojë e sjelljes së qeverisë. Në rastin konkret, deklarimet e dhëna prej tij (kërkuesit) kanë qenë në kuadër të përmbushjes së detyrave parlamentare si përfaqësues i popullit.

4.3 Vendimi është kontradiktor, për sa i përket interpretimit të neneve 119 dhe 120 të KP-së, alogjik dhe me kundërthënie të hapura dhe të fshehta.

4.4 Gjykata e Lartë nuk ka këqyrur asnjë prej provave filmike të paraqitura nga palët, si dhe ka refuzuar marrjen e provave të kërkuara nga kërkuesi, duke e vendosur atë në pamundësi për të realizuar një mbrojtje efektive.

5. ***Subjekti i interesuar*** ka parashtruar se:

5.1 Nuk qëndron pretendimi se vendimi i Gjykatës së Lartë është arsyetuar me vonesë, pasi kërkuesi nuk jep asnjë të dhënë se kur është shpallur apo kur duhej të shpallej. Edhe sikur të jetë i bazuar pretendimi i kërkuesit, ai nuk jep asnjë argument se çfarë pasoje i ka ardhur nga vonesa e arsyetimit të vendimit, pasi ai e ka paraqitur ankimin në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit.

5.2 Pretendimi i kërkuesit se vendimi i Gjykatës së Lartë bie ndesh me praktikën e konsoliduar të

asaj gjykate nuk është i natyrës juridiko-kushtetuese dhe si i tillë nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

5.3 Nuk qëndron edhe pretendimi se interpretimi i neneve 119 dhe 120 nga ana e Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe jologjik. Gjykata e Lartë ka bërë analizë të thellë të këtyre dispozitave dhe ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka kryer vetëm veprën penale të shpifjes.

5.4 Edhe pretendimi se nuk është respektuar barazia e armëve, pasi nuk janë marrë provat e paraqitura nga kërkuesi, nuk është i bazuar. Gjykata e Lartë i ka marrë në shqyrtim provat e kërkuesit, duke vlerësuar nëse ato mund të administrohen ose jo si prova. Është në vlerësimin e gjykatës të arrijë në përfundimin se cilat prova duhen administruar. Për këtë gjë, Gjykata e Lartë është shprehur në vendimin e saj.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit

6. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese".

7. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae,* Gjykata vëren se në përmbajtjen e kërkesës evidentohet standardet kushtetuese që kërkuesi pretendon se mund të jenë cenuar gjatë proceseve gjyqësore. Gjykata rithekson se ajo ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi duhet të trajtohen në këndvështrimin e garantimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim, si dhe të drejtës së mbrojtjes. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione materiae.*

B. Për cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë

9. Kërkuesi pretendon se nuk është respektuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi në arsyetimin e vendimit të atij kolegji ka kundërthënie, gjë që e bën vendimin të cenueshëm. Kërkuesi ka pretenduar para Gjykatës se vendimi i kundërshtuar është kontradiktor, alogjik dhe ka kundërthënie.

10. Gjykata ka theksuar se në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit është me rëndësi thelbësore edhe respektimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar *(shih vendimin nr. 82, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

12. Këto pretendime të kërkuesit lidhen me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të dispozitave penale që parashikojnë veprat penale të fyerjes dhe shpifjes, konkretisht të neneve 119 dhe 120 të KP-së, të cilat janë çështje që i takojnë sferës së kompetencës të gjykatave të zakonshme dhe jo juridiksionit kushtetues. Ai pretendon se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar për rastet e deklaratave politike të deputetëve, duke i

konsideruar ato si pjesë të veprimtarisë së tyre si anëtarë të Kuvendit, ndërsa vendimi objekt shqyrtimi ka arritur në përfundim të ndryshëm nga kjo praktikë.

13. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë ka analizuar çështjen dhe ka arsyetuar se: i)... *në deklaratën ... i akuzuari Edi Paloka ngre akuza konkrete, me emër të përveçëm në drejtim të të dëmtuarit akuzues... Deklarimi ... përbën një pretendim fakti, i cili në vetvete, në mënyrën si është formuluar, përbën një akuzë tejet serioze, konkretisht se i dëmtuari akuzues bashkëpunon me njerëz me precedentë penalë, kujdeset për ta, shkëmben me ta favore;* ii) *Në deklarimin e tij i akuzuari përdor në drejtim të të dëmtuarit akuzues shprehje të tilla, si "siguristh në dijeninë e tij të plotë", "ka përfituar", "po u kthen", "e lejon", "u jep", "kujdeset", shprehje të cilat nuk janë hipotetike dhe nuk lënë të hapur asnjë mundësi për publikun që të hamendësonte apo të krijonte vetë dyshimin e bindjen për faktin e pretenduar dhe të bënte vlerësimin e tij.* iii) *Kërkesa për të provuar të vërtetën e një gjykimi vlerësues (opinioni) është përgjithësisht e pamundur.* iv) *Provat e paraqitura në gjykim nga i akuzuari Edi Paloka, nuk krijojnë asnjë bazë besueshmërie në lidhje me saktësinë apo vërtetësinë e pretendimeve të tij faktike... ato kanë të bëjnë në përgjithësi me veprimtarinë e organeve ekzekutive dhe ligjvënëse në vend, opinione të personave të tretë mbi situatën politike dhe të rendit në vend, qëndrime të mediave, por, asgjë që ka të bëjë me pretendimet faktike të ngritura nga i akuzuari në paragrafin e fundit të deklaratës së tij.".*

14. Nisur nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë është evidente se ajo ka marrë në shqyrtim thelbin, motivin dhe mënyrën sesi kërkuesi është pozicionuar në deklaratat e tij dhe duke analizuar të gjithë deklaratën në tërësi dhe jo vetëm pjesë të saj, ka arritur në përfundimin se këto elemente përbëjnë vepër penale të parashikuar nga neni 120/2 i KP-së. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka ndryshuar praktikën e saj nuk mbështetet në argumente kushtetuese. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave *(shih vendimin nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

15. Nisur nga vlerësimi që ka bërë Gjykata e Lartë lidhur me ekzistencën e elementeve të veprës penale në sjelljen e kërkuesit, Gjykata çmon se vendimi i Kolegjit Penal nuk është kontradiktor dhe nuk ka kundërthënie, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi.

16. Për sa i takon pretendimit të kërkuesit për arsyetimin e vendimit të Kolegjit Penal tej afatit të arsyeshëm, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se vendimi është shpallur në datën 5.6.2015. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese është paraqitur nga kërkuesi në datën 5.11.2015, pra vetëm 5 muaj pas shpalljes së tij. Së pari, kërkuesi nuk jep asnjë fakt se kur është njohur me vendimin e arsyetuar dhe se cila e drejtë kushtetuese i është cenuar nga një arsyetim potencialisht i vonuar i vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe sikur kërkuesi të pretendojë se afati që ka kaluar nga data e seancës deri në marrjen dijeni të vendimit të arsyetuar ka qenë i paarsyeshëm, duke iu referuar datës së seancës gjyqësore të zhvilluar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kërkuesi kishte mundësi të paraqiste kërkesë para kësaj Gjykate për shfuqizimin si antikushtetues të atij vendimi brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Si konkluzion, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim nga kjo Gjykatë, pasi nuk është ngritur në nivelin kushtetues.

17. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

C. Për pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës së mbrojtjes

18. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka kërqyrur asnjë prej provave filmike të paraqitura nga palët dhe se ka refuzuar marrjen e provave të kërkuara nga kërkuesi, duke e vendosur atë në pamundësi për të realizuar një mbrojtje efektive. Si rrjedhim, sipas kërkuesit, nuk është respektuar barazia e armëve midis palëve.

19. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që në radhë të parë legjislacioni procedural dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin penal, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj. Parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr. 2, datë 19.3.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

21. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë. Në jurisprudencën e saj të konsoliduar, Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 38, datë 12.6.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata vëren se në çështjen konkrete, Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim kërkesat e kërkuesit për marrjen e provave të tjera, konkretisht: tabulatet telefonike të të dëmtuarit akuzues në 5 vjetët e fundit, si dhe testin antidoping. Në fund, Gjykata e Lartë ka konkluduar në rrëzimin e kërkesës për testin antidoping, duke e konsideruar si një provë haptazi të panevojshme në këtë gjykim, mbështetur në nenin 151/2 të KPP-së. Ndërsa për sa i përket kërkesës tjetër për administrimin e tabulateve telefonike të të dëmtuarit akuzues për 5 vjetët e fundit, gjykata ka vendosur ta rrëzojë edhe këtë kërkesë në kushtet kur, sipas saj, nga i akuzuari nuk është dhënë asnjë indicie apo lidhje e këtyre tabulateve me objektin e gjykimit dhe personat e përfshirë në të. Nga vendimi objekt gjykimi rezulton se Gjykata e Lartë e ka bazuar qëndrimin e saj në provat e paraqitura në seancë nga të dyja palët në gjykim, ndërkohë që, në përputhje me kompetencat e saj, ka rrëzuar vetëm kërkesat lidhur me provat që ajo i ka konsideruar të panevojshme, pasi kërkuesi nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme për domosdoshmërinë e marrjes së këtyre provave, me qëllim orientimin e gjykatës në arritjen e një vendimi të drejtë. Gjykata e Lartë e ka bazuar në dispozitat procedurale penale vendimin për mospranimin e kërkimeve për marrjen e atyre provave, duke dhënë argumentet e saj në vendimin përfundimtar. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar.

23. Nisur nga sa më lart, Gjykata, në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Edi Paloka, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, por vlerësoj se kërkesa duhej të ishte pranuar për shkak të mosrespektimit nga ana e Gjykatës së Lartë të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në vijim paraqes argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

2. E drejta për të pasur një vendim të arsyetuar është konsideruar si një nga elementet thelbësore dhe garancitë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo nga ana tjetër gjen mbështetje edhe në nenin 142/1 të Kushtetutës, i cili vendos detyrimin për gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre. Gjykata është shprehur se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimin nr.79, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në kuptim të këtij standardi, Gjykata ka përcaktuar elementet që duhet të plotësojë një vendim gjyqësor në mënyrë që ai të konsiderohet se respekton kërkesat e neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës. Ajo ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik *(shih vendimin nr. 29, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në mënyrë që të bëhet i mundur kontrolli i vendimit gjyqësor hierarkisht nga një gjykatë më e lartë, sipas procedurave përkatëse, gjyqtari duhet ta arsyetojë atë duke treguar me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv, por që ai të plotësojë domosdoshmërisht kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Megjithatë, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes e duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban në mënyrë të saktë referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet

e sipërpërmendura. Gjykata ka vënë në dukje se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Sipas shumicës "*nisur nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë është evidente se ajo ka marrë në shqyrtim thelbin, motivin dhe mënyrën sesi kërkuesi është pozicionuar në deklaratat e tij dhe duke analizuar të gjithë deklaratën në tërësi dhe jo vetëm pjesë të saj, ka arritur në përfundimin se këto deklarime bien në sferën mbrojtëse të nenit 120/2 të Kodit Penal. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka ndryshuar praktikën e saj nuk mbështetet në argumente kushtetuese. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (shih vendimin nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.*". Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, bazuar në standardet e mësipërme të cilat janë të detyrueshme për zbatim edhe nga Gjykata e Lartë, vlerësoj se në rastin konkret vendimi i kundërshtuar nuk është logjik në përmbajtje dhe se i mungon koherenca e brendshme, duke pasur mospërputhje mes argumenteve të pjesës arsyetuese të tij. Gjykata e Lartë në vendimin e saj, në pjesën hyrëse ku paraqiten rrethanat e çështjes, vëren se "*nga provat e administruara në seancën gjyqësore ka rezultuar e provuar se në datën 7 janar 2015, shtetasi Edi Paloka, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në ambientet e selisë së Partisë Demokratike dhe në prani të përfaqësuesve të mediave ka lexuar deklaratën me përmbajtjen e mëposhtme...*", pra, ajo pranon se kërkuesi ka folur si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, nga foltorja e kësaj partie dhe në emër të kësaj force politike, siç është pretenduar prej tij edhe në gjykim. Më tej, në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "*nga përmbajtja e deklaratës së datës 7.1.2015, trupi gjykues konstaton se i akuzuari Edi Paloka ka shprehur konsideratat e tij në dy plane, të cilat kjo gjykatë i klasifikon si gjykime vlerësuese dhe deklarime të fakteve konkrete...*", duke iu referuar këtyre deklarimeve si personale të bëra nga vetë deputeti Edi Paloka. Sipas doktrinës penale fakti kriminal duhet të jetë pasojë e një veprimi të kundërligjshëm të dënueshëm të personit që ka kryer veprën penale, ndaj identifikimi i subjektit të veprës penale ka rëndësi për të përcaktuar, në radhë të parë, se kush e ka kryer veprën penale dhe, në radhë të dytë, për të verifikuar nëse sipas ligjit përgjigjet penalisht apo përjashtohet nga kjo. Në vlerësimin tim, Gjykata e Lartë nuk ka arritur të argumentojë qartësisht se cili është subjekti që e ka kryer veprën penale, pra subjekti që duhet të përgjigjet penalisht për të. Në vendimin e saj ajo herë u referohet deklarimeve të bëra si në emër të një subjekti politik, pra si një qëndrim zyrtar i një force politike, e më tej si qëndrime të bëra nga një deputet i Kuvendit, pjesë e kësaj force, çka e bëjnë vendimin jo të qartë. Kjo paqartësi përshkon të tërë linjën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe përforcohet nga fakti se për të arritur në konkluzionin e saj ajo i referohet nenit 45 të KP-së, sipas të cilit përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë që kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave veprave apo kur argumenton se "*sipas nenit 73 të Kushtetutës deputeti mban përgjegjësi për veprën penale të shpifjes edhe kur deklarimet bëhen në Kuvend e jo më kur ato bëhen jashtë Kuvendit...*".

6. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk e ka analizuar veprën penale nga ana subjektive e saj, në mënyrë që të arrinte në konkluzionin se cilat janë përfitimet që ka pasur në rastin konkret i akuzuari, në kuptim të nenit 120 të KP-së. Sipas Gjykatës së Lartë

"*përhapja e këtyre deklarimeve, në shpërdorim të lirisë së shprehjes, është bërë e qëllimshme për të fituar kredo politike nëpërmjet denigrimit e njollosjes së nderit dhe reputacionit të të dëmtuarit akuzues.*". Megjithatë, Gjykata e Lartë nuk ka arritur të argumentojë se cila është kredo politike që ka fituar personalisht kërkuesi, ndërkohë që nga këto deklarime kredo politike mund të fitonte vetëm subjekti politik dhe jo deputeti si i tillë apo edhe si pjesë e kësaj force.

7. Për pasojë vlerësoj se Gjykata e Lartë nuk ka arritur të japë argumente ligjore dhe të identifikojë qartësisht se cili ka qenë pozicioni dhe roli i kërkuesit në dhënien e deklaratave të konsiderura të rreme dhe që kanë cenuar nderin dhe reputacionin e të dëmtuarit akuzes, si edhe nuk ka analizuar nga ana subjektive se cilat kanë qenë përfitimet e tij nga kryerja e këtyre veprimeve të paligjshme. Në përmbajtjen e tij vendimi ka mospëputhje të cilat nuk duhej të ishin anashkaluar nga shumica dhe që ngrenë dyshime në lidhje me respektimin e standardit të arsyetimit të tij.

8. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se pretendimi i kërkuesit Edi Paloka për shfuqizimin e vendimit nr. 8, datë 5.6.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i bazuar, për rrjedhojë kërkesa duhej të pranohej.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Edi Palokën nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar nga Gjykata Kushtetuese për këto arsye:

2. *Gjykata e Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.* E drejta për të pasur një vendim të arsyetuar është konsideruar si një nga elementet thelbësore dhe garancitë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Kjo nga ana tjetër gjen mbështetje edhe në nenin 142/1 të Kushtetutës, i cili vendos detyrimin për gjykatat për të arsyetuar vendimet e tyre. Gjykata është shprehur se funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimin nr. 79, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në kuptim të këtij standardi, Gjykata ka përcaktuar elementet që duhet të plotësojë një vendim gjyqësor, në mënyrë që ai të konsiderohet se respekton kërkesat e neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës. Ajo ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik *(shih vendimin nr. 29, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv, por që ai të plotësojë domosdoshmërisht kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Duke iu referuar qëndrimit të shumicës "*nisur nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë është evidente se ajo ka marrë në shqyrtim thelbin, motivin dhe mënyrën sesi kërkuesi është pozicionuar në deklaratat e tij dhe duke analizuar të gjithë deklaratën në tërësi dhe jo vetëm pjesë të saj, ka arritur në përfundimin se këto deklarime bien në sferën mbrojtëse të nenit 120/2 të Kodit Penal. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë ka ndryshuar praktikën e saj nuk mbështetet në argumente kushtetuese. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor. Gjykata ka pranuar në mënyrë të vazhdueshme se mënyra e vlerësimit të provave është atribut i gjykatave të zakonshme që zgjidhin çështjen konkrete dhe*

nuk i nënshtrohet kontrollit të saj kushtetues. Ajo ka theksuar se kërkesa për marrje provash jo domosdoshmërisht duhet të pranohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe se vlerësimi i tyre është kompetencë e këtyre gjykatave (shih vendimin nr. 34, datë 12.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.".

5. Ndryshe nga sa arsyeton shumica, vlerësojmë se në rastin konkret vendimi i kundërshtuar nuk është logjik në përmbajtje dhe se i mungon koherenca mes argumenteve të pjesës arsyetuese të tij. Gjykata e Lartë në vendimin e saj, në pjesën hyrëse ku paraqiten rrethanat e çështjes, vëren se "*nga provat e administruara në seancën gjyqësore ka rezultuar e provuar se në datën 7 janar 2015, shtetasi Edi Paloka, deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në ambientet e selisë së Partisë Demokratike dhe në prani të përfaqësuesve të mediave ka lexuar deklaratën me përmbajtjen e mëposhtme...*". Me këtë qëndrim pranohet se kërkuesi këto deklarata i ka bërë si përfaqësues i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, nga foltorja e kësaj partie dhe në emër të kësaj force politike. Më tej, në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "*nga përmbajtja e deklaratës së datës 7.1.2015, trupi gjykues konstaton se i akuzuari Edi Paloka ka shprehur konsideratat e tij në dy plane, të cilat kjo gjykatë i klasifikon si gjykime vlerësuese dhe deklarime të fakteve konkrete...*", duke iu referuar këtyre deklarimeve si personale të bëra nga vetë deputeti Edi Paloka. Në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë nuk ka arritur të argumentojë qartësisht se cili është subjekti që e ka kryer veprën penale, pra subjekti që duhet të përgjigjet penalisht për të. Në vendimin e saj ajo herë u referohet deklarimeve të bëra si në emër të një subjekti politik, pra si një qëndrim zyrtar i një force politike, e më tej si qëndrime të bëra nga një deputet i Kuvendit, pjesë e kësaj force, çka e bëjnë vendimin jo të qartë. Kjo paqartësi përshkon të tërë linjën arsyetuese të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe përforcohet nga fakti se për të arritur në konkluzionin e saj ajo i referohet nenit 45 të KP-së, sipas të cilit përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë që kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave veprave apo kur argumenton se "*sipas nenit 73 të Kushtetutës deputeti mban përgjegjësi për veprën penale të shpifjes edhe kur deklarimet bëhen në Kuvend e jo më kur ato bëhen jashtë Kuvendit...*". Gjykata e Lartë duhej të ishte ndalur më gjatë në këtë pikë dhe të argumentonte më qartë nëse ndodhej në kushtet e nenit 45/3 të KP-së dhe se ku qëndron përgjegjësia e personit juridik dhe ku fillon përgjegjësia e personit fizik. Në rast se ajo Gjykatë ishte e mendimit se kërkuesi ka përfaqësuar qëndrimin e partisë ku bën pjesë, atëherë ajo në arsyetimin e vendimit të saj duhej ta bënte të qartë dallimin midis dy subjekteve dhe si rrjedhojë edhe përgjegjësinë e tyre respektive. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka arritur të japë argumente ligjore dhe të identifikojë qartësisht se cili ka qenë pozicioni dhe roli i kërkuesit në dhënien e deklaratave të konsideruara të rreme dhe që kanë cenuar nderin dhe reputacionin e të dëmtuarit akuzues, si edhe nuk ka analizuar nga ana subjektive se cilat kanë qenë përfitimet e tij nga kryerja e këtyre veprimeve të paligjshme. Në përmbajtjen e tij vendimi ka mospërputhje, të cilat ngrenë dyshime në lidhje me respektimin e standardit të arsyetimit të tij.

6. Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimit të saj ka cenuar edhe standardin e gjykimit sipas ligjit të kohës, duke e gjykuar kërkuesin për një vepër penale të shfuqizuar në momentin që është zhvilluar gjykimi. Referuar procesverbaleve të seancës gjyqësore të datës 2.3.2015, subjekti i interesuar, E.R., ka deklaruar se *"...kërkesën për gjykimin e bëj si Kryeministër...nëse trupa juaj do të çmojë se akuzat janë fyerje dhe shpifje ndaj institucionit të Kryeministrit, atëherë i akuzuari të mbajë përgjegjësi sipas ligji...ky gjykim nuk është personal, nuk kam ardhur këtu për të zgjidhur një problem familjar apo personal, por si Kryeministër i Shqipërisë."*. Nga ana tjetër, vetë deklaratat e kërkuesit, siç u tha edhe më lart, të bëra nga selia e Partisë Demokratike dhe në emër të saj, përjashtojnë çdo motiv personal të individit E.P. në shpifjet apo fyerjet në adresë të individit E.R., që do të thotë se ato janë bërë për shkak të detyrës së E.R. si kryeministër i vendit. Në arsyetimin e një vendimi penal, veç të tjerash, merr rëndësi të veçantë analiza e elementeve të anës objektive (mënyra e kryerjes së veprës penale) dhe të anës subjektive (motivi dhe qëllimi i kryerjes së veprës penale), të cilat mungojnë në vendimin e Gjykatës së Lartë, duke e bërë atë alogjik kur

konkludon për deklarimin fajtor të kërkuesit për një vepër penale, ku motivi i kryerjes së saj është gjithmonë personal, pra cenimi apo denigrimi i nderit dhe dinjitetit të një qytetari tjetër. Këto rrethana të çojnë në përfundimin se Gjykata e Lartë, nëpërmjet një vendimi të paarsyetuar, në të gjitha elementet e tij përbërëse, ndonëse *de jure* e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të shpifjes, të parashikuar nga neni 120 i Kodit Penal, *de facto* ajo e ka dënuar atë për një vepër penale të kryer për shkak të detyrës së të dëmtuarit si Kryeministër, pra shpifje për shkak të detyrës, e parashikuar nga neni 240 i Kodit Penal, vepër e shfuqizuar në vitin 2012, gjë që bie ndesh me nenin 29 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë në kohën e kryerjes së saj. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe prokurori i çështjes, i cili në gjykim ka kërkuar pafajësinë e kërkuesit. Gjithashtu, të njëjtin qëndrim ka argumentuar në seancë edhe avokati i kërkuesit, por Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë përgjigje lidhur me të. Në këto kushte, Gjykata e ka deklaruar fajtor kërkuesin duke u mbështetur mbi një bazë ligjore që nuk është më në fuqi, që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin e zhvilluar ndaj tij.

7. Gjykata e Lartë, në këto lloj procesesh gjyqësore, gjykon si gjykatë fakti dhe jo si gjykatë rishikuese, vendimi i së cilës nuk mund të rishikohet nga një gjykatë tjetër, duke i dhënë vendimit formë të prerë. Për këto arsye, nisur nga roli që i është njohur Gjykatës së Lartë në këto procese, ajo duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për garantimin e një procesi të rregullt ligjor ndaj palëve, duke zbatuar me përpikëri kërkesat e ligjit material dhe procedural.

8. Si përfundim, mendojmë se vendimi i asaj Gjykate nuk rezulton që të ketë respektuar kërkesat e procesit të rregullt ligjor, duke cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe standardin kushtetues të gjykimit të çështjes sipas ligjit të kohës kur është kryer vepra penale.

9. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për shfuqizimin e vendimit nr. 8, datë 5.6.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i bazuar, për rrjedhojë kërkesa duhej të pranohej.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Edi Palokën jam kundër qëndrimit të shumicës se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

2. Në ankimin individual kushtetues, mes të tjerash, kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 8, datë 5.6.2015 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është kontradiktor, për sa i përket interpretimit të neneve 119 dhe 120 të KP-së, alogjik dhe ka kundërthënie të hapura dhe të fshehta. Këtë pretendim të kërkuesit shumica e ka analizuar në dritën e standardit të arsyetimit, duke ritheksuar se në funksion të garantimit të së drejtës së aksesit është me rëndësi thelbësore edhe respektimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih § 10 të vendimit*). Po ashtu, shumica ka vlerësuar se bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar *(shih § 11 të vendimit)*.

3. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor, referuar neneve 42 dhe 142/1 të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës*

Kushtetuese). Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrë-veshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese).*

4. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në bazë të nenit 141/1 të Kushtetutës "*Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*". Po ashtu, neni 75/b/2 i KPP-së parashikon se "*Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit*". Në këto raste, duke qenë se Gjykata e Lartë ka juridiksionin fillestar, ajo zbaton dhe i nënshtrohet të njëjtave rregullave procedurale që do të zbatonte në një rast të tillë një gjykatë e zakonshme, pra gjatë gjykimit ajo është e detyruar të hetojë të gjitha rrethanat në mënyrë të plotë, në tërësi dhe në mënyrë objektive dhe ta zgjidhë çështjen *në themel (shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

6. Në çështjen konkrete vlen të theksohet se vendimi objekt kundërshtimi është dhënë nga Kolegji Penal në përfundim të një procesi gjyqësor bazuar në juridiksionin fillestar që i jepet Gjykatës së Lartë nga neni 141 i Kushtetutës dhe i konkretizuar në dispozitat procedurale penale. Karakteristikat e një procesi të gjykimit në themel të çështjes ndryshojnë nga një proces ku Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit rishikues të saj, kontrollon ligjshmërinë dhe bazueshmërinë në ligjin material e procedural të vendimeve të dhëna nga gjykatat më të ulëta. Në fakt, analiza që shumica i ka bërë vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duket se nuk merr parasysh dallimin e mësipërm dhe akoma më pak detyrimin që buron nga jurisprudenca kushtetuese se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Arsyetimi i një vendimi gjyqësor që e ka gjykuar në themel çështjen ndryshon nga arsyetimi i një vendimi rishikues, sepse është natyra e ndryshme e proceseve që e imponon këtë dallim. Në këtë kuptim çmoj se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, duke mos pasqyruar në pjesën e tij arsyetuese argumente që provojnë përmbushjen e kërkesave që lidhen me gjykimin në themel të çështjes, veçanërisht në drejtim të analizës së anës objektive dhe subjektive të veprës penale, nuk ka përmbushur kërkesat që burojnë nga neni 142/2 i Kushtetutës.

7. Në përfundim, nisur nga rëndësia thelbësore që merr respektimi i standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të garantimit të aksesit në gjykim, por edhe të administrimit të drejtësisë dhe për sa kohë kjo kërkesë nuk është respektuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerësoj se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit është i bazuar.

Anëtare: Vitore Tusha

VENDIM
Nr. 43, datë 12.7.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Altina Xhoxhaj	anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 29.3.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 5 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; Këshilli i Ministrave; Ministria e Drejtësisë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 209 të Kodit të Procedurës Civile, në pjesën që nuk njeh të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, që rrëzon kërkesën për caktim mase të sigurimit të padisë, pasi vjen në kundërshtim me nenet 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 18, 42, 43, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë (gjykata referuese) është ngritur nga paditësi V.M. padi me objekt kërkimin e pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit A.M. dhe detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë të regjistrojë këtë pasuri. Të padituri kanë paraqitur kundërpadi, pasi kanë pretenduar fitimin e pronësisë me anë të parashkrimit fitues.

2. Në seancën gjyqësore të datës 21.12.2015 palët e paditura kundërpaditëse paraqitën një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit të padisë. Ato kërkuan të bllokohej pasuria e pretenduar në ZVRPP deri në marrjen e një vendimit gjyqësor të formës së prerë për të parandaluar kryerjen e veprimeve juridike për tjetërsimin e kësaj pasurie. Gjykata referuese, pasi dëgjoi argumentet e palëve, vendosi, me vendim të ndërmjetëm, të rrëzojë kërkesën për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë së padisë, duke bërë me dije palët se ky vendim ankimohet sipas procedurës së ankimit ndaj vendimeve të ndërmjetme.

3. Në të njëjtën datë palët e paditura kundërpaditëse kanë dorëzuar në gjykatë një ankim të veçantë me objekt ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm të rrëzimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të padisë. Gjykata referuese caktoi seancë për të shqyrtuar pranueshmërinë e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Vlorë. Sipas nenit 209 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) "kundër vendimit të gjykatës që ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për ndryshimin ose heqjen e sigurimit të padisë, mund të bëhet ankim i veçantë. Ankimi i vendimit të mësipërm nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të padisë".

4. Gjykata referuese ka evidentuar, nga njëra anë, se KPC-ja nuk njeh shprehimisht të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm që rrëzon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit të padisë dhe, nga ana tjetër, nuk disponon se ndaj këtij lloj vendimi nuk lejohet ankim. Për këto arsye, sipas gjykatës referuese e drejta e ankimit në rastin konkret rregullohet nga neni 470 i KPC-së që parashikon: "*Vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen apo të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së*

bashku me vendimin përfundimtar. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit, brenda 5 ditëve nga shpallja apo njoftimi i tyre." Mbi bazën e kësaj norme gjykata referuese duhej të vendoste mospranimin e ankimit dhe mosdërgimin e tij në Gjykatën e Apelit. Gjykata referuese ka vlerësuar se nëse do të vepronte në këtë mënyrë, kjo do të sillte cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të palës paditëse në elementet e aksesit në gjykatë, të së drejtës së mbrojtjes, të së drejtës për mjete efektive procedurale dhe barazinë e aksesit në gjykatë të palëve ndërgjygjëse. Kështu, sipas gjykatës referuese, neni 209 i KPC-së, që përcakton ecurinë e procesit gjyqësor dhe vijueshmërinë e shqyrtimit gjyqësor të ankimit të veçantë, konkretisht ajo pjesë e këtij neni që nuk njeh ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon kërkesën për caktim të masës së sigurimit të padisë, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Për rrjedhojë, bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, gjykata referuese ka pezulluar gjykimin, duke iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

5. Gjithashtu, përpara gjykatës referuese është paraqitur për gjykim një çështje e ngjashme, ku paditësi G.H. ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit të padisë dhe gjykata referuese e ka rrëzuar këtë kërkesë me vendim të ndërmjetëm. Paditësi ka paraqitur në gjykatën referuese ankim të veçantë ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm. Gjykata referuese ka kryer të njëjtin arsyetim ligjor si më sipër, duke arritur në konkluzionin se neni 209 i KPC-së, në pjesën ku nuk njeh ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm që rrëzon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit të padisë, vjen në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në. Për këto arsye edhe në këtë rast gjykata referuese ka pezulluar gjykimin dhe i është drejtuar Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës.

6. Gjykata, gjatë seancës gjyqësore, pasi ka konstatuar se objekti i të dyja kërkesave të paraqitura nga gjykata referuese është i njëjtë, ka vendosur bashkimin e çështjeve në një çështje të vetme.

II

7. Gjykata referuese ka parashtruar se mosnjohja e ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon kërkesën për caktim të masës së sigurimit të padisë në nenin 209 të KPC-së cenon:

7.1 Nenin 17 të Kushtetutës, pasi kufizon të drejtën e ankimit të veçantë, duke mos ofruar mjete ankimi proporcionalisht të shpejta dhe efektive në situata të ngutshme, siç është edhe rasti konkret i sigurimit të padisë. Dispozita objekt shqyrtimi nuk respekton kriteret e nenit 17 të Kushtetutës për zgjidhje proporcionale dhe kufizim të të drejtave kushtetuese në përputhje me gjendjen që e ka diktuar atë.

7.2 Nenin 43 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, për shkak se nuk ofrohet një mjet ankimi efektiv për rivendikimin e së drejtës së cenuar dhe kontrollin gjyqësor të akteve të gjykatës së juridiksionit fillestar. Në rastin konkret nuk ka asnjë mjet ankimi që të zgjidhë situatën urgjente, por duhet të pritet deri në marrjen e vendimit përfundimtar për t'u ankuar ndaj vendimit të ndërmjetëm. Në këtë mënyrë neni 209 i KPC-së, në pjesën që nuk njeh ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë, nuk përditëson detyrimin për të garantuar një mjet procedural efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ-së. Ankimi ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurimin e padisë përpara të njëjtit gjyqtar që e ka dhënë atë nuk mund të konsiderohet mjet ankimi efektiv.

7.3 Nenet 18 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 14 të KEDNJ-së, pasi shkakton pabarazi ndërmjet palëve ndërgjygjëse për mjete procedurale efektive për ankim dhe akses në gjykatë. Neni 209 i njeh palës së paditur (subjekt pasiv i procesit) mundësinë e kontrollit gjyqësor nga një juridiksion rishikues me anë të ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm për sigurimin e padisë, ndërsa paditësit, kundërpaditësit dhe ndërhyrësit kryesor ia njeh të drejtën e ankimit ndaj vendimit që rrëzon kërkesën për masë sigurimi padie vetëm me vendimin përfundimtar.

7.4 Të drejtën e ankimit efektiv të palës, pasi vendimi i ndërmjetëm që rrëzon kërkesën për marrjen e masës së sigurimit të padisë meqë nuk ankimohet, arsyetohet vetëm minimalisht dhe gjen pasqyrim në procesverbalin e seancës. Në këtë mënyrë pala e interesuar nuk ka mundësi të njihet me arsyet e vendimmarrjes, faktike apo ligjore, të gjykatës që ka rrëzuar kërkesën.

8. ***Subjektet e interesuara,*** Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kanë paraqitur bashkërisht prapësimet si vijon:

8.1 *Në lidhje me legjitimimin:*

8.1.1 Gjykata referuese është mjaftuar vetëm me citimin e dispozitës pa analizuar kuptimin e zgjeruar dhe qëllimin e saj sipas relacionit shoqërues të projektligjit përkatës. Mungesa e kësaj analize nuk justifikon kërkesën e saj për investimin e Gjykatës Kushtetuese.

8.1.2 Gjykata referuese nuk ka arritur ta ngrejë kërkimin në nivelin e parashtrimit të arsyeve serioze për jokushtetutshmërinë e dispozitës. Në parashtrimet e saj nuk argumentohet se zbatimi i dispozitës do të sillte si pasojë shterimin e garancive dhe mosrespektimin e të drejtave kushtetuese. Dispozita objekt shqyrtimi është në përputhje me Kushtetutën dhe nuk cenon asnjë të drejtë kushtetuese.

8.1.3 Gjykata referuese e ka kuptuar *stricto sensu* mjetin që ajo ka për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, duke u mjaftuar vetëm me krijimin e bindjes së saj që në rastin konkret ka një problem kushtetues. Në këtë mënyrë ajo nuk ka marrë parasysh rregullimin e nenit 450 të KPC-së që parashikon rastet e kthimit të ankimit ndaj vendimit të gjykatës, dispozitë e cila parashikon ankim të veçantë në rastin e kthimit të ankimit. Gjykata referuese nuk e ka zbatuar nenin 450 të KPC-së, por ka përdorur një mjet ekstra procedural, duke marrë në shqyrtim ankimin që palët i kanë bërë vendimit të saj. Në praktikën e konsoliduar gjyqësore nëpunësit gjyqësorë të sekretarisë së gjykatave përmbushin detyrimet që cakton neni 450 i KPC-së.

8.1.4 Gjykata referuese nuk ka lëndë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk ka një çështje për të zgjidhur. Ajo megjithëse ka pranuar se sigurimi i padisë nuk mund të bëhej për shkak se objekt i gjykimit në themel ishte një padi njohjeje, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e normës. Çështja për t'u zgjidhur në rastin konkret i takon Gjykatës së Apelit, e cila pasi të shqyrtonte ankimin mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese. Gjykata referuese nuk e përmbush kushtin e pamundësisë së përfundimit të gjykimit pa marrë përgjigje nga Gjykata Kushtetuese për çështjen e kushtetutshmërisë së normës.

8.1.5 Gjykata referuese ka pasur në dispozicion dispozita që e lejonin atë ta zgjidhte çështjen në themelin e saj, por i ka shmangur ato duke mos përmbushur njërin nga kushtet kryesore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

8.1.6 Gjykata referuese nuk ka arritur të vërtetojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit, antikushtetutshmëria e të cilit pretendohet prej saj, dhe zgjidhjes së çështjes konkrete.

8.2 Për themelin e kërkesës:

8.2.1 KPC-ja përmban edhe dispozita të tjera, të cilat, njësoj si neni 209, nuk lejojnë të bëhet ankim i veçantë ndaj disa lloje vendimesh të ndërmjetme, duke i dhënë të drejtë palës kërkuese t'i ankimojë me vendimin përfundimtar, siç janë nenet 62, 75, 35/c, 158/a dhe 160. Zgjidhja e ofruar nga ligjvënësi në nenin 209 parashikohet dhe në dispozita të tjera, çka nënkupton se jo për çdo vendim të ndërmjetëm lejohet ankim i veçantë. Sipas arsyetimit të gjykatës referuese do të duhej të ndryshonim të gjitha këto dispozita që nuk lejojnë ankim të veçantë.

8.2.2 Analogjitë që sjell gjykata referuese nuk qëndrojnë, pasi natyrat e ndryshme të gjykimit administrativ, penal dhe civil nuk mundësojnë zgjidhje të njëjta për probleme që pretendohen si të ngjashme. Në rast të kundërt do të mjaftonte vetëm një kod i procedurave gjyqësore, i cili të rregullonte të gjitha llojet e gjykimeve.

8.2.3 Pretendimi i gjykatës referuese se palët disponojnë mjete të ndryshme ankimi është i pambështetur. Neni 209 garanton barazinë e subjekteve procedurale, të cilave gjykata u rrëzon kërkesën për marrjen e masës së sigurisë së padisë. Të gjithë këto subjekte kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin e ndërmjetëm me vendimin përfundimtar, sipas nenit 470 të KPC-së dhe asnjëra prej tyre nuk vihet në disavantazh në raport me tjetrën. Ndaj dhe pretendimi i gjykatës referuese se neni 209 bie në kundërshtim me nenet 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, është i pabazuar.

8.2.4 Gjykata referuese me argumentet e saj paragjykon pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës kur rrëzon kërkesën për caktim të masës së sigurimit të padisë.

8.2.5 Pretendimi se vendimi i ndërmjetëm që rrëzon kërkesën për caktimin e masës së sigurimit mbetet i pazbardhur dhe si i tillë i paarsyetuar, për shkak se nuk ankimohet, është i pambështetur, pasi vetë gjykata referuese ka arsyetuar vendimin e ndërmjetëm të saj për rrëzimin e kërkesës.

8.2.6 I pabazuar është edhe pretendimi i gjykatës referuese se me bërjen e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe rrëzimin e saj jemi përpara situatës procedurale që nuk lejon gjykatën të revokojë apo ndryshojë vendimin e rrëzimit të kërkesës. Masa e sigurimit të padisë është një vendimmarrje paraprake e gjykatës deri në përfundim të gjykimit, që synon të evitojë pasigurinë e paditësit në lidhje me realizimin efektiv të së drejtës së tij të pretenduar si të mohuar nga palët e tjera. Kjo masë sigurimi, bazuar edhe në nenet 207 dhe 212 të KPC-së, mund të ndryshohet nga gjykata, pasi vetë masa e sigurimit i referohet gjendjes që përbën shkak për vendosjen e saj, ndaj si e tillë mund të ndryshojë.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A.Lidhur me legjitimimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimimit të subjekteve që mund t`i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, që parashikon se "*kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese*". Ndërsa, sipas nenit 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", gjykata apo gjyqtari, kur çmon se ligji është antikushtetues, është i detyruar të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së *çështjes konkrete (shih vendimet nr. 22, datë 11.4.2016; nr. 50, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

10. Gjykata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të parashtrojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën *(shih vendimet nr. 22, datë 11.4.2016; nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë kuptim është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjykata referuese është e detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Në rast se ajo vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin konkret *(shih vendimet nr. 22, datë 11.4.2016; nr. 7, datë 16.2.2015; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 30, datë 17.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

11. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin e nenit 209 të KPC-së, në pjesën që nuk njeh të drejtën e ankimit të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që rrëzon kërkesën për caktim mase të sigurimit të padisë, pasi vjen në kundërshtim me nenet 17, 18, 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, 13 dhe 14 të KEDNJ-së. Ajo ka përcaktuar ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (nenet 209, 315 dhe 470 të KPC-së), ka paraqitur arsye serioze për jokushtetutshmërinë e dispozitës procedurale objekt shqyrtimi e cila sipas saj cenon të drejtën e ankimit efektiv, si dhe ka parashtruar se e ka të pamundur të zgjidhë çështjen procedurale të paraqitur përpara saj pa u shprehur Gjykata Kushtetuese.

12. Për pasojë, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet asaj nëpërmjet këtyre kërkesave për kontroll incidental të normës ligjore. Në vijim Gjykata ka vlerësuar nëse argumentet e paraqitura në kërkesa janë të mjaftueshme dhe të bazuara për të provuar, në nivel kushtetues, shkeljen e parimeve të garantuara nga dispozitat kushtetuese të evidentuara më lart.

B. Për themelin e pretendimeve

13. Gjykata referuese ka argumentuar se norma e kundërshtuar kufizon të drejtën e ankimit të veçantë, duke mos ofruar mjete ankimi proporcionalisht të shpejta dhe efektive në situata të ngutshme, siç është edhe rasti konkret i sigurimit të padisë. Sipas gjykatës referuese, në rastin konkret, pala paditëse nuk ka asnjë mjet ankimi që të zgjidhë situatën urgjente të saj, por duhet të presë deri në marrjen e vendimit përfundimtar për t'u ankuar ndaj vendimit të ndërmjetëm. Mungesa e parashikimit të ankimit të veçantë në rastet kur gjykata vendos rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të padisë, krijon potencialisht urgjencë, rrezik eminent apo pamundësi të ekzekutimit të vendimit përfundimtar në lidhje me rivendikimin e së drejtës subjektive të cenuar.

14. Gjykata në rastin konkret vëren se argumentet e mësipërme të gjykatës referuese, në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës së ankimit, lidhen me situata hipotetike të cenimit të së drejtës materiale të pronës. Nëpërmjet arsyetimit të saj gjykata referuese lë të kuptohet se në rastet kur gjykata rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë krijohen premisa të cenimit të së drejtës subjektive të palës që ka kërkuar caktimin e kësaj mase sigurimi. Krijimin e situatave hipotetike që cenojnë të drejtën e pronës në çështjen konkrete, gjykata referuese ia atribuon mungesës së parashikimit të ankimit të veçantë ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurimin e padisë. Gjithashtu, gjykata referuese i lidh pasojat hipotetike të cenimit me raste kur vendoset, në mënyrë të padrejtë, rrëzimi i kërkesës për sigurimin e padisë. Në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje se gjyqtarët e ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor brenda kuadrit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë. Nisur nga rasti kur gjykata mund të mos e caktojë në mënyrë të padrejtë sigurimin e padisë, nuk përbën shkak për të vënë në dyshim kushtetutshmërinë e normës.

15. Gjykata referuese ka parashtruar se neni 209 i KPC-së, në pjesën që nuk njeh ankim të veçantë ndaj vendimit të gjykatës që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë, nuk përditëson detyrimin për të garantuar një mjet procedural efektiv, sipas nenit 13 të KEDNJ-së. Sipas saj norma që kundërshtohet nuk ofron një mjet ankimi efektiv për rivendikimin e së drejtës së cenuar dhe e drejta e ankimit bashkë me vendimin përfundimtar nuk janë efektivë.

16. Gjykata, referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, ku sqarohet përmbajtja e termit "ankim efektiv", ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetesh, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete *(shih vendimet nr. 9, datë 15.3.2013; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese).*

17. Kërkesa për sigurimin e padisë paraqitet nga paditësi kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë (neni 202 i KPC-së). Mbi këtë kërkesë gjykata vendos me vendim të ndërmjetëm jopërfundimtar. Duke iu referuar dispozitave procedurale që rregullojnë të drejtën e ankimit, në rastin konkret rezulton se sipas nenit 315 të KPC-së vendimet që jepen gjatë gjykimit dhe që nuk janë përfundimtare, mund të ndryshohen ose të revokohen nga gjykata që i ka dhënë, përveçse kur në këtë Kod parashikohet se kundër tyre mund të bëhet ankim i veçantë. Po kështu, sipas nenit 470 të KPC-së, vendimet e ndërmjetme që jepen nga gjykata e shkallës së parë mund të ndryshohen apo të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar.

18. Në vështrim të dispozitave të mësipërme, Gjykata konstaton se mjetet procedurale që ligjvënësi ka parashikuar për të kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm të rrëzimit të kërkesës për sigurimin e padisë janë: a) ndryshimi apo revokimi i vendimit nga e njëjta gjykatë që e ka dhënë atë; b) ankimi ndaj vendimit bashkë me vendimin përfundimtar. Gjykata vlerëson se qëndrimi i gjykatës referuese që mbështetet në arsyetimin e joefektivitetit të këtyre mjeteve ankimore është i pabazuar. Mosparashikimi i ankimit të veçantë ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për sigurimin e padisë nuk e prek në thelb të drejtën e ankimit ndaj

këtij lloj vendimi të ndërmjetëm. Ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e revokimit/ndryshimit të këtij vendimi nga e njëjta gjykatë që e ka dhënë atë, në varësi të gjendjes që përbën shkak për vendosjen e masës së sigurimit të padisë. Përveç kësaj, ligjvënësi ka parashikuar edhe mundësinë e shqyrtimit në apel të ankimit ndaj këtij vendimi të ndërmjetëm së bashku me ankimin ndaj vendimit përfundimtar. Gjykata çmon se mosparashikimi i ankimit të veçantë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në një masë të tillë që të cenojë thelbin apo të pengojë efektivitetin e saj.

19. Gjykata referuese ka pretenduar gjithashtu se norma që kundërshtohet shkakton pabarazi ndërmjet palëve ndërgjygjëse për mjete procedurale efektive, për ankim dhe akses në gjykatë, për rrjedhojë cenon procesin e rregullt ligjor. Neni 209 i KPC-së i njeh palës së paditur (subjekt pasiv i procesit) mundësinë e kontrollit gjyqësor nga një juridiksion rishikues me anë të ankimit të veçantë të vendimit të ndërmjetëm për sigurimin e padisë, ndërsa paditësit, kundërpaditësit dhe ndërhyrësit kryesor ia njeh të drejtën e ankimit ndaj vendimit që rrëzon kërkesën për sigurimin e padisë vetëm me vendimin përfundimtar. Ajo argumenton se kjo i vendos palët në pozita procedurale të pabarabarta, duke penguar realizimin/rivendikimin e të drejtave subjektive të palës e cila nuk mund të bëjë ankim të veçantë.

20. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata vlerëson se në rastet e kërkesave për caktim të masës së sigurimit të padisë palët nuk janë në pozita të barabarta për shkak të pasojave të ndryshme që sjellin vendimet e gjykatës lidhur me këto lloj kërkesash. Kështu, në rastin e pranimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të padisë vendosen kufizime për sa i përket ushtrimit të së drejtave mbi sendin/pasurinë e paluajtshme. Ndërsa në rastin e rrëzimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit të padisë të drejtat mbi sendin/pasurinë e paluajtshme mbeten të pacenuara. Duke qenë se pasojat që vijnë në këto dy raste janë të ndryshme, edhe palët në proces nuk mund të jenë në pozicione të barabarta. Në këto kushte është e kuptueshme se garancia që i është dhënë të paditurit nga ligjvënësi, me anë të ankimit të veçantë, për të kundërshtuar vendimin e pranimit të kërkesës së sigurimit të padisë, i përgjigjet pikërisht pasojave që ky vendim prodhon.

21. Gjykata ka theksuar se ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte apo lirie të caktuar duhet të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Ky kusht e imponon ligjvënësin të evidentojë nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete, si dhe të baraspeshojë ndërhyrjen me zgjedhjen e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë (*shih vendimet nr. 7, datë 16.2.2016; nr. 25, datë 25.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata vëren se KPC-ja përmban edhe dispozita të tjera (nenet 35/c, 62 dhe 75 në referim të nenit 158/a dhe 160), të cilat, njësoj si neni 209, nuk lejojnë të bëhet ankim i veçantë ndaj disa lloje vendimesh të ndërmjetme të gjykatës, duke i dhënë të drejtën palës kërkuese t'i ankimojë me vendimin përfundimtar. Rrjedhimisht, kjo nënkupton se ligjvënësi nuk ka lejuar të bëhet ankim i veçantë për çdo vendim të ndërmjetëm të gjykatës. Arsyet që e kanë çuar ligjvënësin në një zgjidhje të tillë qartazi lidhen me administrimin e drejtësisë, eficiencën dhe ekonominë gjyqësore, si dhe shmangien e ndërhyrjes që mund të ketë ankimi i veçantë në shqyrtimin e çështjes në themel.

23. Gjykata referuese, përpara se t'i drejtohej Gjykatës, duhet t'i kishte vlerësuar në mënyrë substanciale këto arsye, të cilat e kanë shtyrë ligjvënësin të mos parashikojë ankim të veçantë në rastin konkret. Kërkesa për kontroll incidental përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues. Për shkak të rëndësisë që ka vënia në lëvizje e Gjykatës për këto lloj kërkesash, gjykata referuese në këto raste është e detyruar të paraqesë argumente që mbështesin inicimin e këtij procesi, pas një shqyrtimi të plotë dhe objektiv. Ajo duhet të bëjë një hetim të balancuar dhe një analizë të kujdesshme, duke marrë në konsideratë arsyet e ligjvënësit kur kufizon të drejta individuale dhe mjetet e zgjedhura për realizimin e këtyre të drejtave.

24. Siç është theksuar në jurisprudencën e kësaj Gjykate, është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së

normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 7, datë 16.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se argumentet e paraqitura nga gjykata referuese nuk reflektojnë bërjen e një analize të plotë nga ana e saj, sipas standardeve të mësipërme, për të vlerësuar nëse mjeti i zgjedhur nga ligjvënësi cenon thelbin e së drejtës së ankimit. Ajo nuk e ka vlerësuar dispozitën konkrete në raport me dispozita të tjera të ngjashme, ku ligjvënësi nuk ka lejuar ankim të veçantë, si dhe nuk ka arritur të identifikojë arsyet që e kanë çuar ligjvënësin në një zgjidhje të tillë dhe nëse këto arsye kanë justifikuar kufizimin.

26. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se neni 209 i KPC-së është antikushtetues, në pjesën që nuk lejon ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm të rrëzimit të kërkesës për sigurimin e padisë, për arsye të cenimit të së drejtave të ankimit efektiv, aksesit e parimit të barazisë së armëve, është i pabazuar. Për pasojë, Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga gjykata referuese duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72, të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 429 (985), datë 10.6.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ymer Qefa, i biri i Vejsel dhe i Fatime, i datëlindjes 27.4.1951, lindur në Sallbeg, Durrës dhe banues në Lushnjë në datën 1.1.1998.

Caktimin e kërkueses Refije Qazim Kadrie Qefa si kujdestare të shtetasit Ymer Qefa për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasja Zaide Elmazi, e bija e Inez dhe Gjylso, lindur më 20.12.1946, në Tragjas, Vlorë, kërkon shpalljen e vdekjes dhe të zhdukjes së të birit, shtetasit Stiliano Elmazi, në datën 11.9.1995.

KËRKUESE
Zaide Elmazi

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot"
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë